



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësta Org. Org. Jedinica Org Unit	09
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-4570
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	-12-
Data: Datum: Date:	13/06/2024
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

KONTRATË

Titulli: **"Furnizim me pajisje TI-UPS dhe USB"**

Numri i kontratës¹: 206-24-1594-1-3-6/C611

Nr. i Prokurimit: 206-24-1594-1-3-6

Operatori ekonomik: **"Pattern SHPK"**

NUI: **811976903**

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

KONTRATË

Numri i kontratës ²: 206-24-1594-1-3-6/C611

MINISTRIA E SHËNDETËSISË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Pattern SH.P.K., **Rruga Ruzhdi Shabani, nr 47, Lipjan**, (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë: **Furnizim me paisje TI-UPS dhe USB** me numër identifikues: **206-24-1594-1-3-6**

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë furnizimi nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin ng atë dyja palet dhe përfundon pas 60 ditësh.
- 1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 3 ditë nga data e marrjes së urdhëresës.
- 1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë: Ministria e Shëndetësisë.
- 1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP³ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **2,425.00 €**; [Dymijë e katërqindnjëzetepesë Euro].
- 3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Nr rendor	PËRSHKRIMI	Njësia matëse	Sasia e planifikuar	Çmimi për njësi pa TVSH	TVSH	Çmimi per njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1	Furnizim me UPS	cope	21	88.98 €	336.36 €	105.00 €	2,205.00 €
2	Furnizim me USB	cope	20	9.32 €	33.56 €	11.00 €	220.00 €
Grand Total:							2,425.00 €

Neni 4 Pagesat

- 4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.
- Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës.
- 4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

² Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

³ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të furnizimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore





13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në specifiko gjykatën kompetente në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe⁴ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Operatorin Ekonomik	
Emri:	Berat Marmullaku	Emri:	Egzon Rizani
Pozita:	Udhëheqës i Div. te Prokurimit	Pozita:	Person i autorizuar
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	11.06.2024	Data:	11.06.2024
Vula:		Vula:	

⁴ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Prokurimi: 206-24-1594-1-3-6

Nr i brendshëm:

Tituli: Furnizim me paisje TI-UPS dhe USB

1 Furnizim me paisje TI-UPS dhe USB

Kodi i tenderit: 03-01TK

Data: 08.03.2024

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	1. Dokumentat e Biznesit.pdf
2.	2. Deklarata Nen Betim.pdf
3.	3. Deklaratat sipas DT-se.pdf
4.	4. Lista e Punve te ngjashme Referncat- Dëshmit e realizmit të projekteve.pdf
5.	5. Specifikat Teknike.pdf

Përshkrimi i çmimeve

Nr	Emërtimi i grupit	Dokumenti
1.	Furnizim me paisje TI-UPS dhe USB	Lista e çmimeve.pdf

Pjesët e tenderit që do të dorëzohen ndaras:

AUTORITETI KONTRAKTUES

MINISTRIA E SHËNDETËSISË, ZAGREBIT , P.N., -, PRISHTINË,

Zyrtari përgjegjes i prokurimit:

Nr i Prokurimit: 206-24-1594-1-3-6

OPERATOR EKONOMIK:

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **Pattern SH.P.K., Rruga Ruzhdi Shabani, nr 47, 14000, Lipjan, Kosovë**

E-mail: **info@pattern-ks.com**

Personi kontaktues: **Granit Zeqiri**

Telefoni: **049570110**

Faxi:

Numri fiskal: **811976903**

Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 206-24-1594-1-3-6

Titulli i kontratës: Furnizim me paisje TI-UPS dhe USB

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Furnizim me paisje TI-UPS dhe USB

3. Çmimi total i tenderit është:

2,425.00 EUR

Dhe në fjalë *[shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]*

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 30 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender *[shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet]* si partner në konsorcium të udhëhequr nga *[shëno emrin e udhëheqësit]*. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj



PATTERN SHPK.

Phone: + 383 49 570 110, NUI: 811976903

e-mail: info@pattern-ks.com. web: www.pattern-ks.com

Adresa: Rruga Ruzhdi Shabani, nr 47, Lipjan

Për: MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nga: Pattern Sh.P.K.

Titulli: Furnizim me paisje TI-UPS dhe USB

Numri i prokurimit: 206-24-1594-1-3-6

DEKLARATË MBI PËRSHTATSHMËRINË E SPECIFIKACIONEVE TEKNIKE TË DETYRUSHME

Ne kompania "PATTERN" SH.P.K., në bazë të dosjesë së tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktues: **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**, me titull: "Furnizim me paisje TI-UPS dhe USB", me numër të prokurimit: **206-24-1594-1-3-6** deklarojmë me përgjegjësi të plotë juridike se specifikat teknike të ofruara nga ana jonë, përputhen me ato të ANEKSIT 1, të DT-së.

PATTERN SHPK

Datë: 08.03.2024





PATTERN SHPK.

Phone: + 383 49 570 110, NUI: 811976903

e-mail: info@pattern-ks.com. web: www.pattern-ks.com

Adresa: Rruga Ruzhdi Shabani, nr 47, Lipjan

Për: MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nga: Pattern Sh.P.K.

Titulli: Furnizim me paisje TI-UPS dhe USB

Numri i prokurimit: 206-24-1594-1-3-6

DEKLARATA PËR GARANCION DHE AFATIN E LIFERIMIT TË PAJISJEVE


Ne kompania "PATTERN" SH.P.K., në bazë të kërkesës obligative të dosjes së tenderit të publikuar nga Autoriteti Kontraktues: **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**, me titull: " **Furnizim me paisje TI-UPS dhe USB** ", me numër të prokurimit: **206-24-1594-1-3-6**, , deklarojmë me përgjegjësi të plotë juridike se:

furnizimit në bazë të specifikave teknike të Aneksit 1, të realizohet në periudhën kohore 45-60 ditë pas pranimit të fletëporosisë-urdhërbljes nga Autoriteti Kontraktues; dhe

Garancioni i pajisjeve të ofruara nga ana jonë do të jetë 24 Muaj nga data e dorëzimit.

PATTERN SHPK

Datë: 08.03.2024



Aneksi 1.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

NR: 1	Artikkulli	Njësia m.	Sasia	
	UPS	Cope	21	
	Main input voltage	230V		
	Rated power in W	650 W		
	Power Socket outlets	4 Schuko		
	Battery type	Lead-acid battery		
	Input			
	Network frequency	50Hz		
	input voltage limits	140-250V		
	Output			
	Maximum power in W	650W		
	outout frequency	50Hz		
	Waveform type	sinewave		
	transfer time	6ms normal : 10ms maximum		
	Battery	must be 2022 production year(not older than 1 year)		
	Battery voltage	12V		
	battery capacity	9Ah		
	battery power in VAH	108		
	battery life	3-5 years		
	Warranty	2 years		

NR: 2	Artikulli : USB	Njësia m.: Cope	Sasia: 20
	Flash Drive 128GB USB 3.0 Flash Drive 128GB – 4 MB/s		



Deklaratë e garantuesit

GARANCI KONTRATE POLICA NR. 070010460007880

Për: MINISTRIA E SHENDETESISE
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: Pattern SH.P.K.
(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli i prokurimit: Furnizim me paisje Ti-UPS dhe USB

Numri i Prokurimit: 206-24-1594-1-3-6

Garancion me kërkesë te pare

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues.

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitoi sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e Tenderit

DHE NGASE jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtënëshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi Garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej 242.50 € Dy qinde e Katerdhjete e Dy e Pes / njeqind Euro zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërbushja e njërit nga kushtet në vijim :

~~Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se Operatori Ekonomik ka dështuar që të ekzekutoi kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe~~

- Operatori Ekonomik ka dështuar që të ekzekutoi kontratën e nënshkruar, dhe si rezultat i sajë kanë mbet pa u paguar shumë punëtor, nënkontraktor dhe / ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej 242.50 € siç është thënë më lart, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa ma shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen deri me datën 10.9.2024



KOMPANIA E SIGURIMEVE "SIGURIA" | INSURANCE COMPANY
Nënshkrimi dhe vula e garantuesit
Kompania e Sigurimeve "SIGURIA"
Emri i institucionit financiar

Adresa: Rr. Luan Haradinaj Llamella A, Prishtine

Data: 11.6.2024